



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:084463

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05517747

P.nr./..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit H..J.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.698/22 të datës 26.04.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë 28.03.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr./.. e datës 26.02.2024, lidhur në mes të pandehurit H..J.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P...

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.698/22 të datës 26.04.2022.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit H.. J., i lindur me datë në fsh. G.. K. Gj.., tani banon në rr.“ A. T..” nr. 1 K. P., nga babai K.. dhe nënës B.. e gjinisë A.., i njohur me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 26.04.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.598/22 ndaj të pandehurit H..J.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 26.02.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit H..J.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P.., me nr, Nd.nr../.. e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 26.02.2024, lidhur në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P..

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2022:084463, 28.03.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gj y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi